



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Metro Alb sh.p.k”

Adresa : Tirane Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga "Asim Vokshi", Pallati Nr.6, Kati 1, perballe SPAK, Kodi Postar 1057

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Noa Controlcontrol sh.p.k”

Adresa : Tirane Njesia Bashkiake Nr 5, Rruga Nikolla Tupe, Ndërtesa Nr. 3, kati I, Nr.1

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur-Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61646-06-17-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbim verifikim dhe vulosja e matësave”.

Fondi limit: 9.964.500(nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

Shumatorja e çmimeve për njësi 1.581.67(një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një presje gjashtëdhjetë e shtatë)lekë pa tvsh.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.37. Datë 22.06.2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X (Shumatorja e çmimeve për njësi)

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Metro Mad ”sh.p.k & Daisy ETM sh.p.k

L51808031T&L04820001N

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera
gjashtëmbëdhjet) lekë pa tvsh.

1416 (një mijë e katërqind e

2. Noa Controlcontrol sh.p.k

L51622005C

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1570 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.

3. Metro Alb sh.p.k

L24211001V

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera
pa tvsh.

1520 (një mijë e pesëqind e njëzetë) lekë

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. “Metro Mad ”sh.p.k & Daisy ETM sh.p.k

L51808031T&L04820001N

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Metro Mad ”sh.p.k & Daisy ETM sh.p.k Shumatorja e çmimeve për njësi 1416 (një mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjet) lekë pa tvsh.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marrëveshje për bashkimin e operatorëve ekonomikë me nr.456 Rep, 448/2 kol datë 08.07.2020 ku palët kanë renë dakord që detyrat për realizimin e objektit «Shërbim verifikim dhe vulosja e matësave” operatori ekonomik”Metro Mad”sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 20% të shërbimit të kërkuar si dhe operatori ekonomik”Daisy ETM” ka marrë përsipër të realizojë 80% të shërbimeve.

Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

2.6.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019.

2.7.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar nga AK njëri nga operatorët ekonomikë përkatësisht “Daisy ETM” sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim për shlyerjen e taksave vendore datë 20.06.2020, nr.prot 3678 lëshuar nga Bashkia Korçë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të ekstraktit historik të operatorit ekonomik “Daisy ETM” në adresën www.qkb.gov.al vëren se operatori ekonomik “Daisy ETM” ushtron aktivitet edhe aktivitet në Lezhë përkatësisht të regjistruar datë 15.10.2015, me numër çështje CN-348342-10-15 me adresë Lezhë; LEZHË; Lezhe; ; LEZHE; Rruga Beslidhja, Prane Drejtorise se Tatimeve, me nr.pasurie 6/274-12, zona kadastrale nr.8632.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve elektronike KVO konstaton se operatori ekonomik Daisy ETM sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Lezhë për vitin 2019.

Përderisa rezulton që operatori ekonomik “Daisy ETM” sh.p.k ka ushtruar dhe vazhdon të ushtrorë aktivitet pranë Bashkisë Lezhë ka qënë i detyruar të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 ashtu siç është kërkuar në

DT.

Gjithashtu nga verifikimi i ekstraktit historik të operatorit të sipërcituar konstatohet se më datë 04.03.2013 me numër çështje CN-021692-02-13 është regjistruar pranë Bashkisë Durrës me adresë aktiviteti Durrës; DURRES; Durrës; ; DURRES; Rruga S.Xhemali tek Kominet; si dhe Tiranë Kavajë lagjja nr.6.

Përsa i përket adresës të aktivitetit në qytetin Durrës rezulton se është hequr si adresë dytësore datë 18/06/2020 me numër çështje CN-525470-06-20 si dhe është shtuar adresa: "Durrës; DURRES; Durrës; ; DURRES; Lagjja 3, Rruga Skenderbej, Godina 452, Hyrja 2.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik KVO vëren se operatori Daisy ETM pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk ka arritur të paraqesë dhe të dëshmojë se ka shlyer detyrimet vendore për vitin 2019 për vendin ku ushtron aktivitetin përkatësisht Bashkia Durrës si dhe vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 për vendin ku ushtron aktivitetin përkatësisht Bashkia Kavajë.

Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Sqarojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. Noa Controlcontrol sh.p.k

L51622005C

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1570 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.

2. Metro Alb sh.p.k

L24211001V

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 1520 (një mijë e pesëqind e njëzetë) lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë UKT Sh.a, me adresë , Rruga E Kavajës Ndërtesa Nr,133, Njësia Administrative Nr 6, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **22.07.2020**

Ankesa: **JO**